



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 128 Prot

Tiranë, më 26.09.2008

VENDIM Nr. 13 dt. 23.09.2008

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 23.09.2008, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

Sipas pikave të rendit të ditës:

- I. Të diskutojë në mbledhjen e radhës, rregulloren për zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në restaurim.
- II. Të heqë statusin monument kulture i Kat. II, objektit nr. 20, Elbasan:
- III. Të miratojë projektet:
 1. Programi i restaurimit të ikonave të Muzeut Kombëtar, Tiranë.
 2. Sistemim i kangjellave të murit para ish Selamllëkut, lagja Mangalem, Berat.
 3. Punime konservuese në mozaikët e Bazilikave A dhe D të Bylisit, 2008.
 4. Projekti i Teqesë (Tyrbja) e Luzhës, Tropojë.
 5. Restaurim kisha e Shën Mëhillit, Voskopojë.
 6. Restaurim i pikturës murale (A Secco), në muzeun Etnografik, Krujë.
 7. Ndërtimi i murit rrethues të muzeut Etnografik, Krujë.
- IV. Të miratojë kërkesat:
 1. Projekt i zhvendosjes së gurit që po bie në murin e kalasë së Shkodrës.
 2. Restaurimi i banesës Thanas Dino, Gjirokastër.
 3. Restaurimi i banesës Stefan Tushe, Gjirokastër.
 4. Restaurim banesa Vangjel Kaftani, Gjirokastër
 5. Projekt përshtatje, Lokal Lagjja "11 Janari", pronar; Dashnor Mullai, Gjirokastër.
 6. Projekti i restaurimit të rrënojave të banesës më pronar Vefik Kadena, Berat
 7. Projekti i rikonstruksionit elektrik dhe të ndriçimit në Galerinë e Armëve në Kalanë e Gjirokastrës.

8. Rishqyrim i interpretimit të Kalasë së Gjirokastrës.

V. Të miratohet kërkesës për licencë:

Kategoria A, Florenc Sharka.

VI. Nuk u miratuan:

1. Ndryshime në preventivin e projektit të restaurimit të rrugës pedonale, në qendrën historike, Shkodër. (Të interpretohet juridikisht preventivi i projektit)
2. Rikonstruksion banesa e Dabërdakëve, Shkodër. (Të verifikohet objekti në vend)
3. Projekt rikonstruksioni i banesës së Z. Durim Nepravishtës (zonë tampon), Berat. (Të verifikohet objekti në vend)
4. Projekt përshtatje e objektit Vasil Merdani (zonë tampon), Berat. (Të verifikohet objekti në vend)
5. Restaurim i banesës, pronar Halil Ymer Myderrizi, Durrës. (Të verifikohet objekti në vend)
6. Projekt rikonstruksioni, Vila 2 kate, pronar Fatmir Lama, lagja Kala, Elbasan. (Nuk lejohet ndërtimi brenda zonës, në kala)
7. Rikonstruksion i banesës për tu kthyer në Galeri Arti, Elbasan.
8. Rikonstruksion banese me pronar Sofokli Naçi, Korçë.
9. Hotel Colosseo, Shkodër
10. Bar Piazza, Shkodër

VII. Nuk u diskutuan

1. Kërkesa e Bashkisë së Tiranës, për miratimin e projekt idesë fituese “Për Rehabilitimin e Sheshit Skënderbej”.
2. Restaurimi i ambienteve të brendshme të godinës Omarati, Q.Pazarit, Gjirokastrë.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zv/Drejtori
Besim Lila



KRYETAR



Rruga “Aleksandër Mojsiu”, nr. 76, Tiranë (AL), Email: imk@albmail.com